Njoftim për përqendrim me të cilin TELEKABEL SHPKNJP Shtip do të fitojë kontrollin mbi shoqërinë për veprimtari radiodifuzive SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli dhe mbi shoqërinë për prodhim, spedicion, tregti, hoteleri dhe shërbime DUPAR Jovan SHPKNJP eksport-import Gjevgjeli

(lënda nr. 08-156/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 05.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin TELEKABEL SHPKNJP Shtip, me seli në rr. „Vanço Prke“ nr. 88, Shtip, do të fitojë kontrollin mbi Shoqërinë për Veprimtari Radiodifuzive SPAJDER SHPKNJP Gevgjeli dhe mbi Shoqërinë për Prodhim, Spedicion, Tregti, Hoteleri dhe Shërbime DUPAR Jovan SHPKNJP eksport-import Gevgjeli.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

TELEKABEL SHPKNJP Shtip është operator i rrjetit publik të komunikimeve dhe ofrues i shërbimeve publike të komunikimeve, i cili është i notifikuar dhe pjesëmarrës aktiv në tregun e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Është themeluar në vitin 1998.

TELEKABEL SHPKNJP Shtip u ofron abonentëve të tij shërbimet e mëposhtme të komunikimit: qasje në përmbajtje televizive/televizion, internet, telefoni fikse dhe telefoni mobile. Shërbimet e qasjes në përmbajtje televizive/televizion, internet dhe telefoni fikse i ofron përmes rrjetit të vet të komunikimit, ndërsa shërbimin e telefonisë mobile e ofron përmes rrjetit të marrë me qira nga Makedonski Telekom SHA Shkup, si operator virtual i telefonisë mobile.

Shërbimet e komunikimit: qasje në përmbajtje televizive/televizion, internet, telefoni fikse dhe telefoni mobile, TELEKABEL SHPKNJP Shtip aktualisht i ofron në 17 qytete të Maqedonisë.

Mbulimi i plotë me rrjetin e vet të komunikimit, përmes të cilit ofron shërbimet e komunikimit: qasje në përmbajtje televizive/televizion, internet fiks dhe telefoni fikse, përfshin qytetet: Shtip, Manastir, Veles, Strumicë, Kavadar, Koçan, Sveti Nikollë, Shkup, Radovish, Negotinë, Prilep, Gjevgjeli, , Probishtip, Dellçevë, Vallandovë dhe Resnjë.

Shërbimin e telefonisë mobile, me mundësi për qasje në internet mobil, e ofron përmes rrjetit mobil të komunikimit të marrë me qira nga Makedonski Telekom SHA Shkup, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Themeluesi i TELEKABEL SHPKNJP Shtip, z. Robert Dimitrov, është gjithashtu pronar i Shoqërisë për Qarkullim Tregtar ELMAR SHA Shtip, me seli në rr. „Tosho Arsov“ nr. 36, Shtip, e cila ushtron veprimtarinë e dhënies me qira ose menaxhimit me pasurinë e paluajtshme në pronësi të saj dhe ka marrë licencë për ushtrimin e veprimtarisë së kontabilitetit. Kjo shoqëri nuk ushtron veprimtari të njëjta ose të ngjashme me TELEKABEL SHPKNJP Shtip.

SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli është operator dhe ofrues i shërbimeve publike të komunikimeve, i cili është i njoftuar dhe pjesëmarrës aktiv në tregun e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Veprimtarinë e ushtron në territorin e komunave të Gevgjelisë dhe Bogdancit. Veprimtarinë e zhvillon përmes linjave të marra me qira, qasjes në elementet e rrjetit dhe pajisjet përcjellëse, si dhe formave të tjera të qasjes, në atë mënyrë që merr me qira rrjetin publik të komunikimeve elektronike të DUPAR Jovan SHPKNJP eksport-import Gevgjeli, përmes të cilit ofron shërbimet e mëposhtme publike të komunikimeve elektronike: qasje në përmbajtje televizive/televizion dhe internet. Është themeluar në vitin 2001.

DUPAR Jovan SHPKNJP eksport-import Gevgjeli është operator i rrjetit publik të komunikimeve, i cili është i notifikuar dhe pjesëmarrës aktiv në tregun e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Veprimtarinë e ushtron në territorin e komunave të Gjevgjelisë dhe Bogdancit. Është ofrues i shërbimeve të mëposhtme të komunikimeve elektronike: linja të marra me qira dhe qasje në elementet e rrjetit dhe pajisjet përcjellëse, si dhe forma të tjera të qasjes. Rrjetin e vet publik të komunikimeve ia jep me qira SPAJDER SHPKNJP Gjevgjeli, ndërsa nuk ofron shërbime publike të komunikimeve elektronike. Është themeluar në vitin 1992.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregu përkatës mund të përkufizohet si tregu i komunikimeve elektronike në territorin e komunave të Gjevgjelisë dhe Bogdancit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.11.2026

Shkup